

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË

Anetare e Qendres Nderkombetare te Kerkimeve
per Vleresimin e Tendencave Ekonomike, Zurich

CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT TIRANA

A Corporate Member of the Centre for International
Research on Economic Tendency, Zurich (CIRET)

Rezultatet e vrojtimit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 11, tetor 2004

www.qkzh.org

Business and Consumer
Survey Results
No 11, October 2004

Në këtë numër:
Zhvillimet ne sektorin e industrise
perpunuese dhe ndertimit



In this number:
Development in manufacturing and
construction sectors

KLIMA E BIZNESIT/ BUSINESS CLIMATE

Klima e biznesit ne industri: mbetet pozitive

*Business climate in manufacturing
sector: remains positive*

Treguesi i besueshmerise në sektorin e prodhimit gjatë periudhes Janar 2002-Korrik 2004 ka shënuar gjithmonë vlera pozitive, duke treguar që menaxherët e firmave të intervistuar kanë qenë optimistë për aktivitetin e biznesit të tyre. Figura 1 tregon që treguesi i besueshmerise në vitin 2004 është mbi nivelet mesatare të viteve 2002 dhe 2003.

Klima e biznesit ne ndertim: e pranueshme

Business climate: satisfactory

Sipërmarrësit në sektorin e ndërtimit nuk janë aq shumë optimistë në krahasim me ata që operojnë në sektorin e prodhimit. Figura 2 tregon që në 6 mujorin e parë të vitit 2004, treguesi i besueshmerise në sektorin e ndërtimit është duke u përkeqësuar.

FIGURA 1: Treguesi i besueshmerise ne industri
Manufacture confidence indicator





FIGURA 2: Treguesi i besueshmerise ne ndertim
Confidence indicator in construction sector



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Zhvillimet ne sektorin e industrise perpunuese *Development in manufacturing sector*

Klima e biznesit per SME: ne permiresim *Business climate for SME: improving*

Gjatë të gjithë periudhës së vëzhgimit nga Janari i 2002-it deri në Qershorin e 2004-s, klima e biznesit për ndermarrjet me 1-9 punonjes që veprojnë në sektorin e prodhimit jo gjithmonë ka qenë pozitive dhe e kënaqshme. Mjedisi i biznesit për ndermarrjet me 10-49 punonjes ka qenë gjithnjë pozitiv. Pas Janarit të 2004-ës, ky grup ndermarrjesh po akumulon punë pasi drejtuesit e tyre janë optimistë për aktivitetin e biznesit të tyre.

Niveli i kontraktimeve: i pamjaftueshem *Order-books: insufficient*

Figura 4 tregon balancen e pergjigjeve per sa i perket nivelit te kontraktimeve per SME-te. Drejtuesit e tre grupeve te ndermarrjeve sipas madhesisë mendojnë se niveli i kontraktimeve është i pamjaftueshem. Drejtuesit e mikrondermarrjeve janë dhe me te pakenaqurit ku balanca e pergjigjeve ne perqindje është negative me 50 %.

Parashikimi i punesimit: ne rritje *Employment expectation: increasing*

Figura 5 tregon se drejtuesit e tanishëm të ndermarrjeve të vogla janë më optimistë rreth rritjes së shkallës së punësimit në tre muajt e ardhshëm. Rezultatet e anketimit të biznesit për Qershorin e 2004-ës tregojnë se kompanitë mund të rrisin fuqinë e tyre punëtore si rrjedhojë e pritjeve të tyre më të mira në lidhje me aktivitetin e biznesit.

Shfrytezimi i kapaciteteve: ne rritje *Capacity utilization: increasing*

Mikrondermarrjet shfrytezojnë me pak se 50% te kapaciteteve te tyre prodhuese, ndermarrjet e vogla rreth 60% dhe ato te mesme rreth 72%.

FIGURA 3: Treguesi i besueshmerise per NVM-te
Confidence indicator - SME




FIGURA 4: Vleresimi i nivelit te kontraktimeve per NVM-te
Assesment of order-books - SME




FIGURA 5: Parashikimi i punesimit per NVM-te
Employment expectation - SME





FIGURA 6: Shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese per NVM, 2000-korrik 2004
Capacity utilisation, 2002 - June 2004



Pengesat ne sektorin e industrise perpunuese

Constraints within manufacturing sector

FIGURA 7: Shperndarja e ndermarrjeve sipas kufizimeve te ambientit te biznesit (Janar 2002-Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived environment type difficulties (January 2002 – July 2004)




FIGURA 8: Shperndarja e ndermarrjeve sipas kufizimeve ne krahun e ofertes (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived supply difficulties (January 2002 – July 2004)





FIGURA 9: Shperndarja e ndermarrjeve sipas kufizimeve ne krahun e kerkeses (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived demand difficulties (January 2002 – July 2004)



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Për qëllim analize, faktorët që kufizojnë veprimtarinë prodhuese janë klasifikuar në 3 grupe:

Faktorët që ndikojnë kërkesen konsumatore, konkurrenca e importeve etj.

Faktorët që ndikojnë tek oferta, të tillë si mungesa e inputeve të ndryshme, mungesa e aksesit ndaj tregut të kredive etj.

Faktorët që shqetësojnë mjedisin e biznesit në përgjithësi si mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, energjisë, legjislacionit, korrupsioni etj

Mungesa e energjise: pengese e vazhdueshme

Shortage of energy: in high levels

Figura 7 tregon shpërndarjen e ndermarrjeve në sektorin e prodhimit të cilat kanë kufizime që lidhen me mjedisin e biznesit në përgjithësi. Mungesa e energjisë perben pengesen me te rendesishme sipas kufizimeve te ambientit dhe permendet nga mesatarisht 73% të sipërmarrësve. Faktori i dytë në këtë grup është zbatimi jo korrekt i legjislacionit fiskal i përmendur nga 36% e të intervistuarve. Mungesa e infrastrukturës nënvizohet nga 35% e sipërmarrësve.

Aksesi ne kredi: pengese ne renie

Access to credit market: slight effect

Biznesmenët duket se kanë më pak vështirësi me faktorët që ndikojnë në krahun e ofertes se tregut. Figura 8 tregon që mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe problemet financiare janë përmendur nga 26 dhe 25% e të intervistuarve, ndërsa mungesa e fuqisë punëtore nuk përbën një pengesë të rendesishme. Gjithashtu nga figura 8 evidentohet që aksesit ndaj tregut të kredive duket se shqetëson një numër relativisht të vogël të biznesmenëve, meqë ai përmendet vetëm nga rreth 17% e të intervistuarve.

Konkurrenca e pandershme: faktor me influence

Unfair competition: influential factor

Figura 9 tregon që konkurrenca e pandershme nga tregu i zi është një fenomen më shqetësues në krahasim me dy faktorët e tjerë që ndikojnë tek kërkesa e tregut si konkurrenca e importeve, e përmendur mesatarisht prej 23% dhe kërkesa e pamjaftueshme të përmendura nga 19% e të intervistuarve.

Mungesa e energjise: pengese e vazhdueshme per SME-te
Shortage of energy: important factor for SME

Figura 10 tregon ndikimin e faktorëve që kufizojnë infrastrukturën e biznesit sipas kategorive ose klasave të ndërmarrjeve. Kjo figurë tregon se mesatarisht për periudhën nga Janari 2002 deri në Qershor 2004, mungesat e energjisë elektrike është përcaktuar si faktori më problematik i përmendur nga sipërmarrësit. Ky faktor është theksuar nga mikrondërmarrjet me 78%, dhe firmat e vogla me 76% dhe ato të mesmet me 62%. Faktori i dytë më i rëndësishëm është keq zbatimi i legjislacionit fiskal; kështu 44% e mikrondërmarrjeve, 42% e ndërmarrjeve të vogla dhe 33% e ndërmarrjeve të mesme e kanë vlerësuar mungesën e zbatimit të duhur të legjislacionit si faktorin e dytë me të rëndësishëm. Mungesa e infrastrukturës dhe problemi i korrupsionit gjithashtu përmenden si shqetësime nga pronarët e mikrondërmarrjeve dhe të ndërmarrjeve të vogla.

Mungesa e fuqise puntore te kualifikuar: pengese ne rritje
Shortage of skilled labor: increasing constrain

Figura 11 tregon se faktorët që lidhen me ofertën nuk janë shumë shqetësues për drejtuesit e sektorit të SME-ve. Gjithsesi, është e dallueshme se mungesat në punën e kualifikuar po bëhen gjithnjë e më tepër një problem, veçanërisht për ndërmarrjet e mesme (28% e drejtuesve e përcaktojnë këtë gjë si problem). Mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e mesme duket se kanë kufizime financiare (36% e të intervistuarve nga mikrondërmarrjet dhe 34% e të intervistuarve nga ndërmarrjet e mesme e përmendin këtë faktor si problematik).

Konkurrenca e pandershme: faktor shqetësues per SME
Unfair competition: influention factor

Figura 12 tregon se përse i përket kërkesës, mikrondërmarrjet janë goditur veçanërisht nga konkurrenca e pandershme nga tregu i zi (65%). Kërkesa e pamjaftueshme përbën gjithashtu dhe një tjetër faktor kufizues për mikrondërmarrjet. Ndërsa drejtuesit e ndërmarrjeve të mesme nuk duket se shqetësohen nga mungesa e kërkesës ose ndikimi i tregut të zi.

FIGURA 10: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve te ambientit te biznesit (Janar 2002-Korrik 2004)
 Distribution of SME with perceived environment type difficulties (January 2002 – July 2004)




FIGURA 11: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve ne krahun e ofertes (Janar 2002 – Korrik 2004)
 Distribution of SME with perceived supply difficulties (January 2002 – July 2004)






FIGURA 12: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve ne krahun e kerkeses (Janar 2002 – Korrik 2004)
 Distribution of SME with perceived demand difficulties (January 2002 – July 2004)



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Zhvillimet ne sektorin e Ndertimit Development in Construction sector

FIGURA 13: Treguesi i besueshmerise te NVM-ve
Confidence indicator - SME




Klima e biznesit per SME : ne pergjithesi jo e kenaqshme

Business climate for SME: not satisfactory

Figura 13 tregon se gjatë periudhës ndërmjet Janarit të 2002-it dhe Qershorit të 2004-ës ka dy pika kthese në sektorin e ndërtimit të SME-te. E para është gjatë periudhës Janar-Prill 2003, kohë kur NVM-të pësuan një kthim prapa dhe u ndoqën nga tre tremujorë me tendence pozitive biznesi. E dyta është në tetor 2003 kur SME-të ngadalësuan aktivitetin e tyre të biznesit pasi treguesi i besueshmerise për këtë grup ndërmarrjesh eshte ne ulje drejt vlerave negative për të tretin tremujor rradhazi. Gjatë të tre sondazheve të fundit treguesi i besueshmërisë për ndërmarrjet e vogla dhe mikrondërmarrjet vazhdon të jetë akoma negativ (8 pikë) dhe (-33 pike) gjë që do të thotë që mjedisi i biznesit për këtë grup ndërmarrjesh është pesimist. Treguesi i besueshmerise për ndërmarrjet e mesme është ne nivele të kënaqshme, por është pak më i ulët se një vit më parë.

FIGURA 14: Vleresimi i nivelit te kontraktimeve per NVM
Assesment of order-books- SME




Niveli i kontraktimeve per SME-te: i pamjaftueshem

Order-books for SME: insufficient

Figura 14 tregon se kontraktimet nuk jane në nivele të mjaftueshme dhe perben shkakun kryesor për një klimë biznesi pesimiste në sektorin e ndërtimit gjatë 6 muajve të parë të 2004-ës. Niveli i porosive për mikrondërmarrjet është shumë më i vogël se një vit më parë.

FIGURA 15: Parashikimi i punesimit per tre muajt e ardhshem per NVM
Employment expectation- SME



Parashikimi i punesimit per SME: ne rritje

Employment expectation for SME: increasing

Figura 15 tregon se sipërmarrësit e ndërmarrjeve të mesme të ndërtimit janë optimiste rreth perspektivës së tyre të biznesit. Kjo pasi ata mendojnë se diçka e tillë do të rrisë shkallën e punësimit në një të ardhme të afërt. Bilanci i përgjigjeve në Qershor 2004 (17 pikë) është më i lartë se një vit më parë (3 pikë). Për tre tremujorë me rradhë, pronarët e mikrondërmarrjeve në sektorin e ndërtimit kanë deklaruar se ata do të ulin numrin e punonjësve në ndërmarrjet e tyre, duke theksuar se kontributi i këtij grupi ndërmarrjesh në nivelin e punësimit ka të ngjarë të ulet në 2004-ën.

Pengesat ne sektorin e ndertimit

Constraints within construction sector

Faktorët që kufizojnë aktivitetin e biznesit në sektorin e ndërtimit janë shumë të ndryshëm nga faktorët që pengojnë aktivitetin e biznesit në sektorin e prodhimit. Këto faktorë klasifikohen në tre grupe sipas efekteve në krahun e kërkesës, ofertës ose faktorëve kufizues për ambientin e biznesit.

Procedurat për lejen e ndërtimit: faktor pengues në rritje

Building licensing procedures: increasing constrain

Përveç mungesës së energjisë, rreth 56% e menaxherëve mendojnë se procedurat për lejen e ndërtimit përbëjnë një faktor pengues për veprimtarinë e tyre ndërtuese (shih figurën 16). Për më tepër 49% e menaxherëve konsiderojnë zbatimin jokorrekt të legjislacionit fiskal si një faktor kufizues. Problemi i moszbatimit korrekt të ligjit të prokurimit është përmendur nga 31% e të intervistuar.

Mungesa e fuqisë punetore: faktor i paperfillshëm

Lack of labor: insignificant factor

Figura 17 tregon që sipërmarrësit në sektorin e ndërtimit kanë pak probleme që lidhen me faktorët që ndikojnë ofertën. Sidoqoftë, vështirësitë në marrjen e kredive përmenden vetëm nga 27% e të intervistuarve si dhe pengesat financiare nga rreth 19% e menaxherëve të intervistuar. Po kështu shikohet se mungesa e fuqisë punetore është një faktor i paperfillshëm.

Konkurenca e pandershme nga tregu i zi: faktor shqetesues

Unfair competition by black market: an important constrain

Konkurenca e pandershme nga tregu i zi duket se përbën një pengesë të rëndësishme në krahun e kërkesës për firmat që operojnë në sektorin e ndërtimit. Figura 18 tregon që mesatarisht rreth 37% e sipërmarrësve të intervistuar në sektorin e ndërtimit kanë nënvizuar tregun e zi si faktorin që kufizon veprimtarinë e tyre ndërtuese dhe 19% e tyre mendojnë se kërkesa e pamjaftueshme përbën problem për ta.

FIGURA 16: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas kufizimeve të ambientit të biznesit (Janar 2002-Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived environment type difficulties (January 2002 – July 2004)




FIGURA 17: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas kufizimeve në krahun e ofertes (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived supply difficulties (January 2002 – July 2004)





FIGURA 18: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas kufizimeve në krahun e kërkeses (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of enterprises with perceived demand difficulties (January 2002 – July 2004)



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 19: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve te ambientit te biznesit (Janar 2002-Korrik 2004)
Distribution of SME with perceived environment type difficulties (January 2002 – July 2004)




FIGURA 20: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve ne krahu e ofertes (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of SME with perceived supply difficulties (January 2002 – July 2004)





FIGURA 21: Shperndarja e NVM-ve sipas kufizimeve ne krahu e kerkeses (Janar 2002 – Korrik 2004)
Distribution of SME with perceived demand difficulties (January 2002 – July 2004)



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Lejet e ndertimit: pengese per gjithe SME-te
Building licesing: Constrain for all SME-s

Figura 19 tregon se procedurat e licensimit te ndertesave përbëjnë kufizimet e dyta të rëndësishme për SME-të në sektorin e ndërtimit (pas mungesave në energji elektrike). Vetëm ndërmarrjet mëdha nuk shprehen për kufizime reale në lidhje me procedurat e licensimit (shkalla e përgjigjes për këtë grup është 11%), ndërsa sipërmarrësit e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrjeve të mesme ndajnë pak a shumë të njëjtin shqetësim në lidhje me këtë problem. Zbatimi jokorrekt i legjislacionit fiskal përmendet nga 50% e menaxherëve të ndërmarrjeve të vogla, 46% e ndërmarrjeve të mesme, dhe 42% e mikrondërmarrjeve. Figura 19 tregon se faktorë të tjerë si për shembull moszbatimi i drejtë i ligjit të prokurimeve, mungesa e infrastrukturës dhe korrupsionit është një faktor domethënës për SME-të në këtë sektor (ky faktor është përmendur mesatarisht nga 25-35% e të intervistuarve).

Veshtirsite financiare: ndjehet me shume te mikrondermarjet
Financial problems: more concern to micro enterprises

Ashtu si dhe në sektorin e prodhimit, faktorët kufizues që kanë ndikim në krahu e ofertës per ndërmarrjet janë identifikuar në një shkallë shumë më të ulët se sa tipet e tjera të kufizimeve. Nga Figura 20 mund të shihet që SME-të në sektorin e ndërtimit kanë disa probleme përsa i përket aksesit në tregun e kredive, si dhe kanë dhe kufizime financiare (të përmendur mesatarisht nga 20-30% e të intervistuarve).

Tregu i zi: ndikon ne te gjithe SME-te
Black market: affect all SME-s

Figura 21 tregon që mikrondërmarrjet ndikohen më shumë nga aktiviteti i sektorit formal pasi mesatarisht 42% e tyre kanë përmendur këtë faktor. Rreth 40% e pronarëve të mikro ndërmarrjeve kanë përmendur se kanë kërkesë të pamjaftueshme. Ky faktor duket se ka lidhje pozitive me madhësinë e ndërmarrjeve, pasi ndërmarrjet mesatare nuk paraqesin ndonjë shqetësim real rreth kërkesës së ulët.

Liber:

Albert Gajo: Shqiperia Demokraci ne Deficit - Analize e zhvillimeve ekonomike, politike dhe institucionale
Botim i QKZH, Tirane 2001

Lista e studimeve

Vleresimi i veshitresive te biznesit ne sektorin e industrise – Shtator 2001, financuar nga UNIDO/UNDP

Vleresimi i ndikimit te NVM ne rritjen ekonomike ne Shqiperi: 1997 – 2000 – dhjetor 2002, financuar nga SEED/
ETI

Vleresimi i aktivitetit te mikro-ndermarrjeve ne zonat periferike – gusht 2003, financuar nga Banka Boterore

Vleresimi e pengesave administrative ne sektrin e ndertimit – maj 2003, financuar nga SEED/Shoqata e ndertuesve
te Shqiperise

Mbeshtetja e jashtme per NVM dhe roli i Agjensive Rajonale te Zhvillimit – Shtator 2003, financuar nga Chemonics
International Inc./USAID

Veshtrim kritik mbi hartimin dhe zbatimin e programit te shpenzimeve buxhetore ne Shqiperi: 1994-2002 - tetor
2003, financuar nga MSI/USAID

Integrimi i rinise ne tregun e punes: Pengesat dhe Veshitresite – qershor 2003, financuar nga Fondacioni per
Shoqerine e Hapur (Fondacioni Soros)

Nxitja e zhvillimit te sektorit privat: Vleresimi i veshitresive dhe ndikimit te aktivitetit informal ne sektorin e
sherbimeve – gusht 2003, financuar nga Partners/USAID

Opinionin dhe Qendrimi i Qytetareve per Reformen Arsimore ne Shqiperi - tetor 2003, financuar nga fondacioni
per Shoqerine e Hapur (Fondacioni Soros)

Metodologjia e indikatorëve te performances se ndermarrjeve te vogla dhe te mesme - maj 2004, financuar nga
SEED/IFC

INTRA-BALKAN CONSULTANT, Sh.p.k.

Intra-Balkan Consultant sh.p.k. (IBC) ofron konsulence financiare dhe juridike për institucionet publike dhe private. IBC është veçanërisht e specializuar për kryerjen e analizave në fushën e zhvillimit të tregjeve dhe aktiviteteve të veçanta, përcaktimin e rreziqeve, studimin e kërkesës konsumatore për produkte apo shërbime të veçanta në Shqipëri dhe më gjërë, si dhe ndikimin e sistemit fiskal mbi aktivitetin e biznesit.

Ne jemi të sigurve se do te japim alternativën më të mirë për biznesin tuaj.

Intra-Balkan Consultant Ltd (IBC) provides financial and legal consultancy service for public and private institutions. IBC is especially specialised for market research, risks appraisal, analysis of consumer demand for goods and services in Albania and other countries as well as the impact of fiscal legislation to businesses.

We are sure that we will give you the best solution for your business activity.

QKZH/CRD TIRANA

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)69 22 40 906
E-mail: info@qkzh.org